



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.55/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kryetarit të subjektit politik NISMA Social Demokrate Fatmir Limaj njëherë edhe kandidat për deputet nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA - Nisma Social Demokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.01.2025, merr këtë:

### **VE N D I M**

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.55/2025 e datës 17.01.2025

II. Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA - Nisma Social Demokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 8,000.00 (tetëmijë) euro.

III. Detyrohet Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA - Nisma Social Demokrate, Konservatorët, Intelektualët, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### **A r s y e t i m**

Me datën 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se kryetari i subjektit politik NISMA për Kosovën, njëherit kandidat për deputet nga koalicioni AAK-NISMA, ka mbajtur tubim zgjedhor dhe takim me punonjës të Shtëpisë së Shëndetit në Malishevë "Shpëtim Robaj" në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me anë të këtij veprimi, janë shkelur rëndë dispozitat ligjore duke shfrytëzuar institucionet publike të shëndetësisë për tubime publike zgjedhore dhe duke takuar dhe shfrytëzuar punëtorët e institucionit përkatës. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë ka bashkangjitur postimin në facebook dhe fotografitë bashkëngjitur.

[https://www.facebook.com/stoy.php?story\\_fbid122209006496197296&id61555918907966&rdid=HNJ1K18M8at72Mog#](https://www.facebook.com/stoy.php?story_fbid122209006496197296&id61555918907966&rdid=HNJ1K18M8at72Mog#)

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik NISMA për Kosovën për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 18.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 18.01.2025, të subjektit politik NISMA për Kosovën Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe NISMA për Kosovën, e kundërshtojnë në tërësi ankesën e parashtruar nga LVV, për shkak se veprimi i Kryetarit të subjektit politik NISMA për Kosovën nuk bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, 2 dhe 3 të LZP-së. Nga vet emërimi i nenit 36 të LZP-së kuptohet se kjo dispozitë përcakton se cilat janë veprimet e ndaluara nga nëpunësi publik dhe jo veprimet e ndaluara nga liderët politik, nga çka rrjedhë se z. Limaj nuk mund ti mveshen shkeljet e përcaktuara me nenin 36 të LZP-së, shkelje këto të pretenduara nga LVV.

Përderisa për PZAP theksojmë se z. Limaj nuk ka mbajtur tubim politik dhe as zhvilluar fushatë zgjedhore në Shtëpinë e Shëndetit Shpëtim Robaj në Malishevë siç pretendon LVV, por i njëjti ka shkuar në vendin e lartcekur për të parë nga afër investimet e Komunës së Malishevës. Kjo rrethanë mund të vërtetohet nga agjenda politike e subjekteve të koalicionit AAK - NISMA, ku nga të gjitha rrjetet sociale dhe mjetet tjera informative të cilat i shfrytëzojnë subjektet politike për të ftuar votuesit e tyre për pjesëmarrje në tubimet e tyre, askund nuk mund të gjendet ndonjë thirrje - ftesë drejtuar votuesve të tyre që të paraqiten për të dhënë mbështetjen e tyre politike në Shtëpinë e Shëndetit Shpëtim Robaj në Malishevë.

Se vizita e z. Limaj në Shtëpinë e Shëndetit Shpëtim Robaj në Malishevë nuk ka qenë për qëllime të tubimit politik apo zhvillimit të fushatës zgjedhore, vërtetohet nga fakti se z. Limaj ka qenë prezent në institucionin shëndetësor të lartcekur pas përfundimit të orarit të kësaj Qendre Mjekësore. Nga çka rrjedhë se i njëjti me vizitën e tij nuk ka pasur për qëllim që të ndikojë te një masë e caktuar e qytetarëve të asaj zone, e me vizitën e tij as që ka penguar procesin e zakonshëm të punës që zakonisht zhvillohet në këtë institucion.

Nga vet postimi në rrjetin social facebook i z. Limaj dhe fotografitë të cilave u referohet ankuesi LVV, shihet se edhe efekti i vizitës së z. Limaj nuk ka qenë efekti që arrihet në rastet kur i njëjti mbanë tubime politike gjatë fushatës së tij zgjedhore. Lidhur me këtë kërkon nga PZAP-i që të merr parasysh fotografitë të cilave u referohet LVV dhe të njëjtat ti krahasoj me fotografitë si në vijim, e më pas të vlerësoj nëse për PZAP rezulton se qëllimi i vizitës së z. Limaj në Shtëpinë e Shëndetit Shpëtim Robaj ka qenë zhvillimi i fushatës zgjedhore.



Koalicioni AAK - NISMA vlerëson se nëse synimi i PZAP është që realisht të vërtetohet nëse z. Limaj ka shkuar në Shtëpinë e Shëndetit në Malishevë që të mbajë tubim politik siç pretendon LVV, atëherë pa mëdyshje PZAP do të sjell vendim me të cilin do të refuzoj ankesën e LVV, pasi nga krahasimi i fotografive të bashkëngjitura si më lartë shihet dallimi si në numër të njerëzve pjesëmarrës ashtu edhe në paraqitjen e z. Limaj me rastin e shpërndarjes së fotografive në rrjetet sociale si facebook etj. Si dëshmi ka bashkëngjitur fotografi nga tubimi politik i z. Limaj në Malishevë. Andaj i propozojnë PZAP-së që ankesën me numër A.nr.55/2025 të parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj Kryetarit të subjektit politik NISMA për Kosovën, njëherë kandidat për deputet nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - NISMA, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesa është bazuar**

Paneli, ka gjetur se postimi i fotografisë dhe tekstit mbi të i postuar në llogarinë e facebook-ut të kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Fatmir Limaj, të ofruara si provë materiale, në ankesë të Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që subjekti në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, ka mbajtur tubim zgjedhor në ambientet e Shtëpisë së Shëndetit në Malishevë, “Shpëtim Robaj“, dhe në këtë foto konstatohet se në këtë tubim zgjedhor është përfshirë edhe stafi mjekësor, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par. 2, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “*Gjatë fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik*”.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Koalicioni AAK - NISMA, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e pjesëtarëve të stafit dhe hapësirat Shtëpisë së Shëndetit në Malishevë, “Shpëtim Robaj“, përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet për afërsisht të ngjashme.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e Koalicioni AAK- NISMA, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku thekson se dispozitat e nenit 36 të LZP-së përcaktojnë veprimet e ndaluara nga nëpunësit publik dhe jo veprimet e ndaluara nga liderët politik, Paneli vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara për faktin se paragrafi 2 i këtij neni përcakton se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësit publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik. Andaj me këtë rast

Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA - Nisma Social Demokrate, Konservatorët, Intelektualët ka bërë fushatë zgjedhore në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara ligjore. Të gjitha pretendimet e tjera nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.55/2025 më datën 19.01.2025

**Kryesues i Panelit**

Bujar Muzaqi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.